

Vendim nr. 82 datë 18.04.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marsida Xhaferllari, Anëtare
Marjana Semini, Anëtare

në datën 18.04.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (Sh) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “KATALENA” SH.P.K., përfaqësuar nga avokate Adelina Hoxha.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 3775, datë 21.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1956, datë 16.09.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-3236, datë 26.07.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 49, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), neni 1 i Protokollit 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja shoqëria “Katalena” sh.p.k. është regjistruar person juridik, me objekt të aktivitetit të saj kryerjen e studimeve në sektorin e ndërtimeve, projekttimeve, zbatimin e punimeve të ndërtim-montimit, prodhimin e materialeve të ndërtimit, si dhe importin-eksportin e të gjitha llojeve të mallrave në territorin e Shqipërisë.

2. Në kuadër të aktivitetit të saj tregtar shoqëria “Katalena” sh.p.k. ka lidhur një marrëveshje me pronarët e një trualli për ndërtimin e një objekti shumëkatësh (4-6 kate dhe dy kate nën tokë) në Linzë, komuna Dajt, dhe pasi është pajisur me leje ndërtimi nr. 16, datë 17.11.2005 nga Këshilli i Rregullimit të Territorit pranë komunës Dajt ka filluar punimet për realizimin e ndërtimit.

3. Në qershor të vitit 2006 shoqëria “Katalena” sh.p.k. ka lidhur me shoqërinë “Aleksandros” sh.p.k. kontratën nr. 3906 rep. dhe nr. 310 kol., datë 20.06.2006 për sipërmarrjen e kryerjes së punimeve. Në objekt të marrëveshjes përcaktohej se sipërmarrësi, (shoqëria “Aleksandros” sh.p.k.) me mjetet financiare të porositësit (shoqëria “Katalena” sh.p.k.), do të kryente punimet për llogari të porositësit në objektin që ai ndërtonte. Për punimet e kryera sipërmarrësi do të shpërblehej nga porositësi me çmimet e caktuara në kontratë. Në vijim, palët kanë nënshkruar marrëveshjen nr. 1894 rep., nr. 290 kol., datë 12.03.2009, objekti i së cilës ishte përcaktimi i saktë i detyrimeve respektive dhe afati brenda të cilit duhej përmbushur detyrimi.

4. Në vijim, kërkuesja, me qëllim ekzekutimin e marrëveshjeve, ka autorizuar nëpërmjet tre prokurave administratorin e shoqërisë “Aleksandros” sh.p.k., shtetasin A.I., për të lidhur kontrata në emër dhe për llogari të saj. Kërkuesja, me aktin nr. 1270 rep., 331 kol., datë 31.08.2009, të titulluar “Shfuqizim prokure”, ka shfuqizuar tre prokurat.

5. Mes kërkueses dhe shoqërisë “Aleksadros” sh.p.k. ka lindur mosmarrëveshje civile për mosrespektimin e marrëveshjeve të sipërcituara. Për këtë arsye, shoqëria “Aleksandros” sh.p.k. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke paditur kërkuesen për konstatimin e pavlefshmërisë së aktit noterial nr. 1270 rep., nr. 331 kol., datë 31.08.2009 dhe detyrimin të zbatojë marrëveshjen nr. 1894 rep. dhe nr. 290 kol., datë 12.03.2009, të paguajë kamatat për shumën e papaguar, si dhe të paguajë për çdo ditë vonesë pas datës së ekspertimit.

6. Ndërsa shoqëria “Katalena” sh.p.k. ka paraqitur kundërpadi me objekt zgjidhjen e kontratës së sipërmarrjes nr. 3906 rep. dhe nr. 310 kol., datë 20.06.2006, si dhe të shtesës së saj për faj të sipërmarrësit, shoqërisë “Aleksadros” sh.p.k., detyrimin për të dëmshpërblyer kërkuesen për zgjidhjen e kontratave dhe detyrimin e administratorit të shoqërisë

“Aleksandros” sh.p.k. t’i dorëzojë kërkuceses kontratat e porosisë të lidhura me të tretët, arkëtimet e realizuara nga këto kontrata, si dhe punimet e kryera.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3775, datë 21.03.2014, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke detyruar kërkucesen të përmbushë detyrimin që rrjedh nga marrëveshja në shumën 173.150 euro në favor të shoqërisë “Aleksandros” sh.p.k. Detyrimin e kërkuceses të paguajë interesat në lidhje me këtë shumë nga dita e ngritjes së padisë (13.09.2010) deri ditën e relatimit të aktit (datë 12.03.2012) në shumën 8940 euro dhe tej kësaj date deri ditën e ekzekutimit të vendimit interesat mesatarë ditorë në vlerën 16 euro/në ditë. Këtij detyrimi duhet t’i zbritet shuma prej 10.532 eurosh, e cila rezulton nga gabimi në përlllogaritje në aktmarrëveshjen e datës 12.03.2009. Rrëzimin e pjesës tjetër të padisë dhe të kundërpadisë.

8. Pas ankimit të shoqërisë “Aleksandros” sh.p.k. dhe kërkuceses, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1956, datë 16.09.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 3775, datë 21.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në këtë mënyrë: detyrimin e shoqërisë “Katalena” sh.p.k. t’i paguajë shoqërisë “Aleksandros” sh.p.k. shumën 197.150 euro, si dhe interesin bankar nga data 12.03.2009 deri në ekzekutimin e vendimit; rrëzimin e pjesës tjetër të padisë dhe kundërpadisë.

9. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuësja dhe ka paraqitur kundërrekurs shoqëria “Aleksandros” sh.p.k., ndërsa në datën 26.07.2016 kërkuësja ka paraqitur shtesë rekursi. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-3236, datë 26.07.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuceses, me arsyetimin se është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

10. Kërkuësja në datën 24.01.2024 (*sipas shënimit të shërbimit postar*) i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë sipas objektit, e cila është regjistruar përfundimisht në datën 05.02.2024, pas plotësimit të dokumenteve.

II

Pretendimet e kërkuceses

11. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

11.1. *Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, e pavarur dhe e paanshme*, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka shqyrtuar çështjen me një gjyqtar, në shkelje të rëndë të parashikimeve ligjore procedurale, konkretisht të nenit 35 të KPC-së. Nisur nga objekti i padisë, si dhe i kundërpadisë, vlera e

kontratës së sipërmarrjes është mbi 50 milionë lekë dhe çështja duhet të ishte gjykuar me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

11.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykatë*, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, nuk ka analizuar provat dhe nuk ka arsyetuar për pretendimet e kërkueses dhe në veçanti të atyre lidhur me paligjshmërinë për mosparaqitjen e situacioneve të shoqërisë “Aleksandros” sh.p.k. Gjykatat e rrethit dhe e apelit nuk kanë arsyetuar pse është rrëzuar kundërpadia dhe në vendimet e tyre nuk janë mbështetur në faktet që janë paraqitur në proces. Vendimet janë jologjike dhe aspak të qarta në përmbajtje. Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk përmbush kërkesat për një vendim të arsyetuar, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs dhe në shtesën e rekursit. Në vendim Gjykata e Lartë është shprehur se të metat e hetimit të gjykatës së shkallës së parë janë plotësuar nga gjykata e apelit, por nuk ka arsyetuar se cilat ishin këto të meta të hetimit që janë plotësuar nga gjykata e apelit. Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim sipërfaqësor dhe në shkëlqje të parimit të ligjshmërisë, duke u shprehur se “*ligjshmëria e mbajtjes së dokumenteve fiskale nga pala paditëse nuk mund të përjashtojë palën e paditur nga përmbushja e detyrimit ndaj palës paditëse*”. Ajo nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit për cenimin e rëndë të objektivitetit nga ekspertja e caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë edhe për arsyen se kishte marrë pjesë në një gjykim tjetër me paditëse L.S. dhe të paditur shoqërinë “Katalena” sh.p.k.

11.3. *Parimit të lirisë ekonomike dhe parimit të sigurisë juridike*, pasi gjykatat kanë marrë vendime të padrejta, duke u dhënë të drejtë subjekteve që nuk respektojnë ligjin për deklarimin dhe pagimin e detyrimeve në organet tatimore.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që

cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se kërkesja, si person juridik i së drejtës private, legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

14. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë. Ky kriter kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Nga ana tjetër, duhet theksuar se bëhet fjalë për shterimin e mjeteve juridike *efektive*, në kuptimin e shterimit të atyre mjeteve që janë të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimet nr. 11, datë 28.02.2024; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Kolegji vëren se kërkesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual duke parashtruar pretendime për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, e pavarur dhe e paanshme, të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykatë dhe parimin e sigurisë juridike, si dhe të parimit të lirisë ekonomike dhe parimit të sigurisë juridike.

16. Për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesja ka pretenduar cenimin e gjyqimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, e pavarur dhe e paanshme, por, në thelb, argumentet lidhen me gjykimin nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi, sipas saj, çështja duhet të ishte gjykuar me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë për shkak të vlerës së padisë. Kolegji konstaton se nga përmbajtja e dosjes gjyqësore të administruar për nevoja të shqyrtimit të çështjes, kërkesja pretendimin nuk e ka parashtruar as në apel, as në rekurs. Për më tepër, Kolegji vëren se referuar paragrafit të dytë, shkronja “a”, të nenit 35 të KPC-së, sipas

përmbajtjes në kohën e shqyrtimit të çështjes, gjykata e shkallës së parë gjykante me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë paditë me vlerë më shumë se 20 milionë lekë vetëm nëse një nga palët e kërkonte në seancë përgatitore dhe sipas procesverbalit të seancës përgatitore të datës 27.10.2010 në atë gjykatë, kërkesja nuk ka paraqitur kërkesë për gjykimin me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkesja nuk i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për pretendimin e cenimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj gjatë gjykimit në shkallë të parë.

17. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-mujaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin konkret konstatohet se vendimi më i fundit në kohë (vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë) i kundërshtuar nga kërkesja mban datën 26.07.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 24.01.2024. Për sa i përket përmbushjes së këtij kriteri, kërkesja ka pretenduar se me vendimin është njohur në datën 22.12.2023 kur është paraqitur në sekretarinë e Gjykatës së Lartë dhe ka tërhequr një kopje të vendimit, që mban shënimin: “*U paraqit për tërheqje vendimi sot më 22.12.2023*”.

18. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se si datë e fillimit të afatit ligjor 4-mujor për paraqitjen e tij, në rastin e procesit gjyqësor, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor që përbën mjetin e fundit ankimor. Kur objekt i ankimit kushtetues individual është një vendim i Gjykatës së Lartë, si datë e marrjes dijeni për vendimin gjyqësor është ajo kur vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare të saj ose përmes njoftimit elektronik të tij, kur palët kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 40, datë 14.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në vijim, referuar standardeve në lidhje me momentin e marrjes dijeni të vendimit të fundit objekt kundërshtimi, është kërkuar informacion nga Gjykata e Lartë për momentin e bërjes të disponueshëm për palët të vendimit të saj. Me shkresën nr. 890/1 prot., datë 19.02.2024 Gjykata e Lartë ka informuar se vendimi nr. 00-2023-3236, datë 26.07.2023 është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 16.10.2023, datë në të cilën palët mund ta dispononin këtë vendim.

20. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se në kushtet kur kërkesja prej datës 16.10.2023 ka pasur mundësi të njëhej efektivisht me vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Lartë, paraqitja nga ajo të ankimit kushtetues individual në datën 24.01.2024 (data e shërbimit postar) vlerësohet brenda afatit ligjor 4-mujor, për rrjedhojë kërkesja legjitimohet *ratione temporis*.

21. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkesja ka parashtruar pretendime për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykatë, si dhe të lirisë të veprimtarisë ekonomike dhe parimit të sigurisë juridike. Kolegji vëren se për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe parimit të sigurisë juridike kërkesja ka parashtruar se gjykatat kanë marrë vendime të padrejta, duke u dhënë të drejtë subjekteve që nuk respektojnë ligjin për deklarimin dhe pagimin e detyrimeve në organet tatimore. Në këtë drejtim, Kolegji vlerëson se, në thelb, pretendimi lidhet me qëndrimin e mbajtur nga gjykatat gjatë shqyrtimit të çështjes, për rrjedhojë do të analizohet së bashku me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit, i cili garantohet në nenin 42 të Kushtetutës, i cili *prima facie* hyn në juridiksionin kushtetues dhe do të analizohet në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit

22. Kërkesja ka pretenduar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka analizuar provat dhe nuk ka marrë një vendim të arsyetuar, duke mos u shprehur për pretendimet e saj dhe në veçanti për paligjshmërinë në mosparaqitjen e situacioneve të shoqërisë “Aleksandros” sh.p.k. Sipas kërkeses, të dyja gjykatat në vendimet e tyre nuk janë mbështetur në faktet që janë paraqitur në procesin gjyqësor dhe vendimet nuk përmbajnë bazën ligjore ku bazohet mosmarrëveshja, si dhe nuk kanë arsyetuar pse është rrëzuar kundërpadia. Kërkesja ka parashtruar se vendimet janë jologjike dhe aspak të qarta në përmbajtje dhe vendimi i Gjykatës së Lartë nuk përmbush kërkesat për një vendim të arsyetuar, pasi nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs e në shtesën e rekursit. Sipas kërkeses, qëndrimi i Gjykatës së Lartë se ligjshmëria e mbajtjes së dokumenteve fiskale nga pala paditëse nuk mund të përjashtojë palën e paditur nga përmbushja e detyrimit ndaj palës paditëse, cenon parimin e ligjshmërisë.

23. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Shteti i së drejtës nuk

mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 6, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

24. Sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë, i qartë dhe jo kontradiktor në përmbajtje (shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese).

25. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Gjykata nuk mund të bëjë vlerësim të provave, interpretim të ligjit dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të sistemit gjyqësor (shih vendimet nr. 19, datë 02.04.2012; nr. 7, datë 27.04.2005; nr. 106, datë 01.08.2001 të Gjykatës Kushtetuese).

26. Në çështjen konkrete, procesi gjyqësor ka nisur për padinë e shoqërisë “Aleksandros” sh.p.k., që ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë së marrëveshjes nr. 1270 rep., nr. 331 kol., datë 31.08.2009 të lidhur me kërkesën, detyrimin e saj që ta zbatojë atë dhe të paguajë kamatat për shumën e papaguar nga data 12.03.2009 deri në ekzekutimin e vendimit. Ndërsa kërkesja ka paraqitur kundërpadi me objekt zgjidhjen e kontratës së sipërmarrjes nr. 3906 rep., nr. 310 kol., datë 20.06.2006, si dhe të shtesës së saj nëpërmjet aktmarrëveshjes nr. 1894 rep., nr. 290 kol., datë 12.03.2009 dhe detyrimin e shoqërisë “Aleksandros” sh.p.k. për ta shpërblyer për zgjidhjen e kontratave për faj të saj, si dhe detyrimin e administratorit të shoqërisë “Aleksandros” sh.p.k. për të dorëzuar të gjitha arkëtimet e realizuara nga kontratat e porosisë të lidhura me të tretët.

27. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3775, datë 21.03.2014, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke detyruar kërkesën të përmbushë detyrimin në shumën 173.150 euro dhe interesat në lidhje me këtë shumë. Gjykata e rrethit ka vendosur rrëzimin e pjesës tjetër të padisë për pavlefshmërinë absolute të aktit noterial për shfuqizimin

e prokurave dhe të kundërpadisë si të pabazuar në ligj dhe në prova. Gjykata e rrethit në vijim ka arsyetuar se nga provat shkresore ka rezultuar se ka qenë shoqëria “Katalena” sh.p.k. ajo që me veprimet e saj nuk ka përmbushur detyrimin në kohën e përcaktuar në marrëveshje dhe se ky fakt nuk e legjitimon në kërkimin e saj për zgjidhjen e kontratës si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore të pretenduara. Po kështu, ajo nuk mund të pretendojë dorëzimin e sendit nga paditësi/i kundërpaditur në një kohë kur objekti është poseduar nga të tretë (banorë) prej vitesh dhe administrimi, mirëmbajtja janë realizuar prej tyre (*shih faqet 9-11 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*). Për administratorin e shoqërisë “Aleksandros” sh.p.k., gjykata e rrethit ka arsyetuar se ai ka vepruar si administrator dhe jo si individ, duke vendosur rrëzimin e kërkimeve si të padisë dhe kundërpadisë.

28. Pas ankimeve të kërkueses dhe shoqërisë “Aleksandros” sh.p.k., Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1956, datë 16.09.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit për detyrimin, duke përcaktuar shumën 197.150 euro, si dhe interesin bankar për këtë shumë; rrëzimin e pjesës tjetër të padisë dhe të kundërpadisë. Gjithashtu, gjykata e apelit ka thirrur për sqarime ekspertin që kishte përgatitur aktin e ekspertimit, duke i ngarkuar edhe detyra për sqarimin e plotë të aktit. Gjykata e apelit ka arsyetuar në të njëjtën linjë si gjykata e rrethit dhe ka vlerësuar se ajo gjykatë ka analizuar drejt provat e administruara, duke dalë në përfundime të bazuara lidhur me zgjidhjen ligjore të pretendimeve respektive të palëve.

29. Ndaj vendimit të gjykatës së apelit kërkuesja ka ushtruar rekurs, shoqëria “Aleksandros” sh.p.k. ka paraqitur kundërrkurs, si dhe në datën 26.07.2016 kërkuesja ka paraqitur shtesë rekursi.

30. Kolegji vëren se nga përmbajtja e vendimit të Kolegjit Civil në pjesën hyrëse janë listuar shkaqet e rekursit të ushtruar nga kërkuesja, si dhe janë pasqyruar pretendimet e parashtruara nga ajo në shtesën e rekursit të datës 26.07.2016, mes të cilave ishte edhe pretendimi për paanshmërinë e ekspertes në gjykimin në shkallë të parë (*shih faqet 12-13 dhe 16 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se gjykatat më të ulëta kanë respektuar normat procedurale të cilat mund të çojnë në pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor ose të procedurës së gjykimit. Gjykatat kanë respektuar dhe zbatuar drejt ligjin material, kanë kryer një analizë juridike të plotë të provave dhe e kanë zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Gjykata e Apelit e ka riçelur hetimin gjyqësor dhe në plotësim të të metave të aktit të ekspertimit kontabël ka bërë një përlllogaritje të saktë të detyrimit të mbetur në përputhje me aktrakordimin e datës 12.03.2009 dhe me veprimet e tjera të kryera në përmbushje të detyrimit të mbetur. Kolegji Civil ka arsyetuar se ligjshmëria e mbajtjes së dokumenteve fiskale nga pala paditëse nuk mund të

përrjashtojë palën e paditur/kërkuesen nga përmbushja e detyrimit. Në përfundim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-3236, datë 26.07.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi ishte bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së.

31. Në analizë të sa më sipër, Kolegji vlerëson se nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore të gjykatës së rrethit dhe të apelit e plotësojnë standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Ato u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të kërkueses, të cilat, në thelb, lidhen me mënyrën se si gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë zbatuar ligjin dhe vlerësuar provat për zgjidhjen e çështjes konkrete, konkretisht aktmarrëveshjet e lidhura mes palëve dhe dispozitat e Kodit Civil për pjesën e detyrimeve. Në vijim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendim është shprehur për shkaqet e mospranimin të rekursit, duke u dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në të që lidheshin me kryerjen e veprimeve nga palët në funksion të përmbushjes së detyrimeve sipas marrëveshjeve të lidhura mes tyre, me plotësimin e aktit të ekspertimit nga gjykata e apelit dhe me ligjshmërinë e mbajtjes së dokumenteve fiskale, duke vlerësuar se ishin bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon ligji dhe se një pjesë e pretendimeve lidhej me vlerësimin e provave, duke dalë jashtë juridiksionit të Gjykatës së Lartë. Ndërsa për pretendimet e parashtruara në shtesën e rekursit, Kolegji thekson se standardi i arsytimit të vendimit konsiderohet i plotësuar, me kusht që pretendimet e shtesës së rekursit të jenë pasqyruar në pjesën hyrëse të vendimit të Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, sikurse u evidentua, shkaqet e parashtruara në shtesën e rekursit janë pasqyruar në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegji Civil të Gjykatës së Lartë (*shih faqen 16 të vendimit*).

32. Për sa më lart, vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk rezulton të jetë i paqartë, alogjik, të ketë kundërthënie ose të mos ketë pasqyruar në mënyrë të mjaftueshme argumentet në mbështetje të përfundimit të shprehur në dispozitiv. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor i lidhur me të drejtën e aksesit është haptazi i pabazuar.

33. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.